



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:191868

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05443636

Ac.nr.7698/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Arsim Hamzaj-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: H. B. me Nr. Personal të Letërnjoftimit: **xxxx** A. R. me Nr. Personal të Letërnjoftimit:**xxxx**; Z. G. me Nr. Personal të Letërnjoftimit: **xxxxxx**; V. S. me Nr. Personal të Letërnjoftimit: **xxxxxx**; dhe N. A. me Nr. Personal të Letërnjoftimit: **xxxxxx** të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. B.P. me seli të zyrës në Vushtrri, Rruga xxxxxxxx p.n, kundër të paditurës: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, Rruga “...” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensimin e pagave të trembëdhjeta, shpërblimin jubilar dhe shujtave, vlera e kontestit: 18,608.52 Euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.6885/21, të datës 25.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më **13.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR, ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.6885/21, i datës 25.07.2023, në pikën **I** të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Pika **II** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.6885/21, i datës 25.07.2023, **mbetet e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.6885/21 të datës 25.07.2023, jashtë seancës, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET E BAZUAR pjesërisht kërkesëpadia e paditësve H.B., A. R., Z. G., V.S. dhe F. H. dhe **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë që paditësve t’ia paguaj shumat si vijon:

- i. Paditësit **H. B.**, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 627.66 Euro, shumën në lartësi prej 1,822.98 Euro;
- ii. Paditësit **A.R.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 627.66 Euro, shumën në lartësi prej 1,822.98 Euro; si dhe si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 % të një page mesatare të vitit 2022 në vlerë prej 142.97 Euro në shumë të përgjithshme prej 1,965.95 Euro
- iii. Paditësit **Z. G.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 571.90 Euro, shumën në lartësi prej 1,143.80 Euro; si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 % të një page mesatare të vitit 2020 në vlerë prej 174.07 Euro në shumë të përgjithshme prej 1,317.87 Euro;
- iv. Paditëses **V. S.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 561.29 Euro, shumën në lartësi prej 1,683.87 Euro;
- v. Paditësit **F. H.** në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, për çdo vit t’ia paguaj në vlerë të pagës bazë nga 605.21 Euro, shumën në lartësi prej 1,815.63 Euro si dhe si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 25 % të një page mesatare të vitit 2022 në vlerë prej 142.97 Euro në shumë të përgjithshme prej 1,958.60 Euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit nga dita e parashtrimit të padisë 26.07.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 724.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve H. B., A.R., Z.G., V. S. dhe F. H. me të cilin kanë kërkuar që “të DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, që paditësve H. B., A. R., Z. G., V. S. dhe F. H. kompensimin për pagat e trembëdhjeta për vitin 2021, për paditësit A. R. për vitin 2020 për paditësin Z.G. për vitin 2018, që në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) ditore nga data 14.11.2018 e deri me datën e zgjidhjes së kontestit dhe pagesën për pagë jubilarë me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare dhe për pjesën e shpenzimeve të procedurës të kërkuara nga i autorizuari i paditësve Av. B. P. për shumën 624.00 Euro për precizimin e padisë dhe shumën 624.00 Euro për përpilimin e kërkesës për zmadhimin e kërkesëpadisë dhe 624.00 për përpilimin e kërkesës së brendshme”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se i njëjti aktgjykimin e ankimuar e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit (pjesës aprovuese të kërkesëpadisë së bashku me kamatë vonesën dhe shpenzimet e procedurës), me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo të njëjtin ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, brenda afatit ligjor, kanë ushtuar përgjegjje në ankesë duke i refuzuar në tërë pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, H. B.: A. R., Z. G., V. S., N. A., përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim B. P., avokat nga Vushtrria, me datë 27.07.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018,2019 dhe 2020, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, në lartësinë e kërkuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, brenda afatit ligjor, përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e njëjta është e palejuar sepse paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të ankimit, ashtu siç parashihet me nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 79 i Ligjit Nr.03/L-212 të punës. Tutje ka theksuar se e kundërshton edhe kërkesëpadinë e paditësve për sa u përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej ka theksuar se pagesat për shujta ditore janë realizuar varësisht prej mjeteve buxhetore të aprovuara dhe atë vetëm për një pjesë të zyrtareve policor të cilët janë të

angazhuar në raste të veçanta. Ka shtuar se Udhëzimi Administrativ i të paditurës ku është mbështetur kërkesëpadia e paditësve nuk ka veprim retroaktiv, si dhe nuk është në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, sipas saj Policia e Kosovës, nuk mund të vendos për ndarjet buxhetore me anë të Udhëzimit Administrativ, por ato përcaktohen me anë të ligjit që i nënshtrohen miratimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si i tillë, UA nr.02/2018 sa i përket implikimeve financiare nuk ka fuqi të prodhoj efekte financiare të cilat nuk janë paraparë me Ligjin mbi Ndarjen e Buxhetit, dhe mbi bazën e kësaj nuk mund të ketë përparësi një udhëzim administrativ ndaj ligjit. Me propozim për Gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në padi, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, ashtu që ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka theksuar se gjykata pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes në padi, provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës.

Sipas vërtetimit të punësimit me Nr. të Ref. 07/1-01SAP-P/4294 të datës 07.06.2021 është vërtetuar fakti se paditësi H.B. për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 627.66 Euro për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2018 dhe 2020 Gjykata vërtetoi faktin se paditësi për këto vite kanë pasur vlerësim të përgjithshëm për vitet 2018 dhe 2020, me notën 4 - vlerësimin plotësisht të kënaqshëm. E paditura përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ekzistimin e ndonjë vërejtje, që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e gjithashtu nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj tij.

Sipas vërtetimit të punësimit me Nr. të Ref. 07/1-01SAP-P/3720 të datës 27.04.2021 është vërtetuar fakti se paditësi A.R. për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 627.66 Euro për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2018 dhe 2020, Gjykata vërtetoi faktin se paditësi për këto vite kanë pasur vlerësim të përgjithshëm për vitet 2018 dhe 2020 me notën 4 - vlerësimin plotësisht të kënaqshëm. E paditura përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ekzistimin e ndonjë vërejtje, që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e gjithashtu nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj tij.

Sipas vërtetimit të punësimit me Nr. të Ref. 04/01-03/SRR-BNJ-P/489/2021 të datës 06.05.2021 është vërtetuar fakti se paditësi Z. G. për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 615.01 Euro për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin

kalendariq 2018, 2019 dhe 2020 Gjykata vërtetoi faktin se paditësi për këto vite kanë pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4 - vlerësimin plotësisht të kënaqshëm. E paditura përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ekzistimin e ndonjë vërejtje, që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e gjithashtu nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj tij.

Sipas vërtetimit të punësimit me Nr. të Ref. 04/01-03SRR-BJN-P/484/2021 të datës 06.05.2021 është vërtetuar fakti se paditësja V. S. për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 561.29 Euro për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendariq 2018, 2019 dhe 2020 Gjykata vërtetoi faktin se paditësja për këto vite kanë pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4 - vlerësimin plotësisht të kënaqshëm kurse vitin 2020 notën 5 – vlerësimin tejkalim i kërkesave. E paditura përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ekzistimin e ndonjë vërejtje, që do të vinte në dyshim performancën e paditëses për vitet e lartcekura, e gjithashtu nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj saj.

Sipas vërtetimit të punësimit me Nr. të Ref. 04/1-03/SRR-BNJ-P/042//2021 të datës 31.03.2021 është vërtetuar fakti se paditësi F. H. për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 605.21 Euro për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendariq 2018, 2019 dhe 2020, Gjykata vërtetoi faktin se paditësi për këto vite kanë pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4 - vlerësimin plotësisht të kënaqshëm në vitin 2018 kurse për vitet 2019 dhe 2020 notën 5 – vlerësimin tejkalim i kërkesave. E paditura përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ekzistimin e ndonjë vërejtje, që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e gjithashtu nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj tij.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”* Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me vlerësimet e performancës, lartësinë e pagës dhe datën e punësimit tek e paditura, Gjykata ia fali besimin e plotë.

Për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, bazuar në faktet dhe provat e paraqitura, kjo Gjykatë vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*.

Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 2 të këtij paragrafi parashihet *“ Staf civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetës edhe administrative”*. Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi Administrativ është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. ndërsa paragrafi i 5 përcakton se: *“Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”*.

Nga dispozitat ligjore të sipërcituara, faktet dhe provat e paraqitura, kjo Gjykatë vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si të punësuar pranë saj t’ia paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit dhe shpërblimin për vitet jubilarë për paditësit e cekur në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi pasi që janë plotësuar edhe kushtet ligjore sipas dispozitave të lartcekura, kjo pasi që vlerësimi për paditësit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 nga ana e të paditurës ka qenë kryesisht plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtëve nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019 dhe 2020 Gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezultojnë vlera e pagave të cilat i realizon paditësit, andaj për vitet 2018, 2019 dhe 2020, i takojnë shumat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata, e aprovoi kërkesë padinë e paditësit Z. G. për sa i përket shpërblimit jubilar në shumën prej 174.07 (viti jubilar i arritur në vitin 2021) sipas pagës mesatare në shkallë prej 25% për vitin 2021 dhe paditësve A. R. dhe F. H. (viti jubilar të dy paditësit e arrijnë në vitin 2022) në shumë prej nga 142.97 Euro sipas pagës mesatare në shkallë prej 25% për vitin 2022 në Policinë Kosovës bazuar në të dhënat zyrtare të konstatuara nga lista e bashkangjitur me pagën mesatare për vitin 2022, në email-in e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Kjo Gjykatë ka vlerësuar se nga një raport i tillë juridik, paditësi e kanë cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura rolin e debitorit, referuar nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve si në shumat e cekura në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit, me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, është vendosur që të detyrohet e paditura që paditësve t’ia kompensoi shumat e gjykuara.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike relevante. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, nuk kanë dhe se e paditura ka kërkuar buxhet shtesë nga Ministria e Financave por se kjo e fundit e ka refuzuar kërkesën për buxhet shtesë. Gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimi Administrativ i lartcekur është miratuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Koordinimi

në mes të Policisë së Kosovës apo Ministrisë së Punëve të Brendshme me Qeverinë e Republikës së Kosovës përkatësisht Ministrinë e Financave në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Udhëzimi Administrativ 02/2018, është çështje e brendshme e të paditurës me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Ministrinë e Financave dhe kjo në asnjë mënyrë nuk afekton apo cenon në të drejtat e paditësve dhe detyrimin e të paditurës. Për më tepër, Gjykata thekson se derisa të drejtat e paditësit janë qartë të specifikuara, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve si në shumatat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesëpadinë e paditësve që në emër të kompensimit të ushqimit të në punë (shujtave) nga data 14.11.2018 me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes së kërkesës e deri në pagesën përfundimtare si dhe pjesën refuzuese të kërkesë padisë së paditësve për pagat e trembëdhjeta, vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi për refuzimin e kompensimit në emër të pagave të trembëdhjeta për paditësit H. B., A. Rr., Z. G., V. Sy. dhe F. H. pasi që për këta paditës nuk ka prova lidhur me formularët e vlerësimit të performancës për vitet e kërkuara si në kërkesë padi, prandaj këto kërkesa të paditësve rezultojnë të pa bazuara.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e shujtave ditore për ditët e prezencës në punë pasi që paditësit nuk kanë arritur që të provojnë se këtu me të paditurën si punëdhënës kanë raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësit për kompensimin e shujtave ditore.

Pretendimi i paditësve se në neni 29 par. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës përcakton detyrimin mbi ushqimin gjatë ditëve të punës, Gjykata e gjeti si të pa bazuar, pasi që në neni 29 par. 1 të këtij udhëzimi parashihet që *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”* pra kjo dispozitë përcakton kushtet të përgjithshme të cilave palët kontraktuese, duhet të ju përmbahen lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, ku kriter për vendosur mbi këto të drejta duhet të jetë vendi i punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici, por si dispozitë nuk përcakton në vetvete detyrimin për kompensim, e në këtë çështje kontestimore - kompensimin për shujta ditore. Gjykata në kuptim të nenit 47 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë ku përcaktohet se *“Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”* vlerëson se për të ju njohur e drejta për kompensim në shujta duhet të përcaktohet shprehimisht në Ligj apo në

aktet e brendshme nënligjore e që në rastin konkret nuk është përcaktuar shprehimisht me aktet nënligjore të paditurës se personelit policor i takon e drejta e kompensimit në shujta ditore.

Gjykata ka refuzuar kërkesën për shpenzimet e procedurës mbi shumat e pranuar dhe atë si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, kjo pasi që kërkesa ka të bëjë me shpenzimet të procedurës në emër të parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë dhe shpenzimet për përpilimin e kërkesës së brendshme tek e paditura secila këto në lartësi nga 624.00 Euro. Gjykata thekson se precizimi është dashur të bëhet për shkak se i autorizuari i paditësve padinë e ka dorëzuar në Gjykatë me të meta. Shpenzimet për precizim mund të pranohen vetëm në raste kur padia e paraqitur është e qartë dhe nuk mban të meta. Në rastin konkret i autorizuari i paditësve ka mundur që të parashtrij padinë që i përmban të gjitha elementet sipas legjislacionit në fuqi dhe të bëjë të pa nevojshme kërkesën e Gjykatës që padia të kthehet për përmirësim - precizim, ndërsa këtë nuk e ka bërë në rastin konkret, kurse fakti që padia është rregulluar sipas kërkesës së Gjykatës kjo nuk i jep të drejtë të kërkojë shpenzime e procedurës për këtë parashtrësë – precizim. Kurse sa i përket kërkesës për shpenzime të procedurës në emër të përpilimit të kërkesës së brendshme tek e paditura, Gjykata mbështetet tek nenin 449 par 1 të LPK-së i cili thotë: *“Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor.”* ku kjo Gjykatë vlerëson se përpilimi i kërkesës së tillë tek e paditura nga ana e përfaqësueses së autorizuar të paditësit nuk hyjnë në harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor që është zhvilluar pranë kësaj Gjykate, rrjedhimisht kërkesa për përpilimin e kërkesës së brendshme tek e paditura e cila është bërë para se të fillojë procesi gjyqësor duhet të refuzohet. Po ashtu Gjykata refuzoi edhe njohjen e shpenzimeve për përpilimin e parashtrësës për zmadhimin e padisë sepse e njëjta nuk ishte e plotë pasi që nuk përmbante provat materiale mbi të cilat i autorizuari i paditësve është dashur t’i bashkëngjis në rastin e zmadhimit të kërkesës padisë dhe pasi që Gjykata ka vendosur ta refuzoj pjesën e kërkesës padisë sipas zmadhimit të padisë nga parashtrësja e lartcekur, të autorizuarit të paditësit nuk i njihen shpenzimet e procedurës lidhur me këtë parashtrësë.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi duke hedhur poshtë kërkesëpadinë e paditësve H. B. dhe V. S. për kompensim në emër të shpërblimit jubilar sepse paditësi H. B. vitin jubilar e ka arritur në vitin 2014 dhe paditësja V. S. vitin jubilar e ka arritur në vitin 2015 rrjedhimisht këto kërkesa të paditësve, kjo Gjykatë vlerëson se janë të pabazuara, për arsye se ju mungon baza juridike për këtë kërkesë padi pasi që UA i lartcekur ka hyrë në fuqi në vitin 2018, ndërsa në rastin konkret vitet jubilarë të njëjtë i kanë mbushur para hyrjes së në fuqi të këtij UA, dhe ky UA nuk prodhon efekte juridike prapavepruese.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, Gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë (26.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata është bazuar në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumën prej 724.00 Euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 624.00 Euro, dhe në emër të taksës për padi shumën prej 100.00 Euro sipas Tarifës së OAK-së

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pikat e atakuara me ankesë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë,.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtënë. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare marrëdhënie e punës e paditësit tek e paditura, vlerësimi pozitiv i performacës për paditësit nga e paditura për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore për paditësit e po ashtu edhe lartësia e pagave. E paditura nuk ka arritur të provojë se i ka kompensuar paditësit pagat e kërkuara.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi me kujdes pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së Aktgjykimit ankimor ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si pasojë e shkeljeve procedurale të nenit 398 të LPK-së për faktin se nuk ka hapur fare shqyrtim lidhur me prapësimin e të paditurës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të atakuar gjeti një pretendim i tillë është i pabazuar.

Nga interpretimi i nenit 398 të LPK-së del se në qoftë se, pas marrjes së përgjigjes në padi, gjykata konstaton se, ndërmjet palëve kontestohen faktet relevante, ajo do të caktojë seancat gjyqësore për vërtetimin e tyre, mirëpo, nëse konstaton se, ndërmjet palëve nuk është kontestuese

gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor gjykata mund të japë aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë. Fjala “mundet” e përdorur në këtë dispozitë e lë në diskrecionin e gjykatës dhënien e aktgjykimit të tillë, mirëpo, meqenëse ligjdhënësi me këtë zgjidhje ligjore ka synuar që në rastet kur gjendja faktike është e qartë dhe jo kontestuese ndërmjet palëve, procedura gjyqësore duhet të përfundojë në afatin sa më të shkurtër dhe me sa më pak shpenzime, rezulton se gjykatat do të duhej që të jepnin aktgjykimin pa procedim të mëtejshëm, sa herë që plotësohen kushtet e parapara me këtë dispozitë. Në këtë rast aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 paragrafi 2 pika n) për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i ka dhënë arsyt lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës në këtë çështje kontestimore të cilat arsye Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i pranon si të drejta dhe ligjore.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se kërkesëpadia e paditësve duhet të hudhet si e palejuar për shkak se nuk i kanë shtjerr mundësitë e ankesës brenda institucionit të të paditurës në kuptim të nenit 78 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit thekson se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashkrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kompensimin e pagës së 13-të do ta bënin vetën në bazë të mundësive buxhetore të punëdhënësit ngase asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim ligjor, se me qëllim të sigurimit të mjeteve buxhetore për realizimin e kësaj pagese, Policia e Kosovës me datë 24.10.2017 përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme ka parashtruar kërkesë buxhetore sipas Qarkores Ref 2018/02 për periudhën 2018-2020 që të ndahet një shumë e caktuar e mjeteve për mbulimin e kërkesave të tilla, kërkesa e Policisë së Kosovës nuk është aprovuar nga ana e autoritetit miratues- Ministrisë së Financave. Këto pretendime e paditura nuk i ka mbështetur me asnjë provë konfm nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së ku parashihet se *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, për më tepër çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 02/2018, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës ne Policinë e Kosovës dhe

atë me nenin 29 paragrafi 1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2 përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune te e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018,2019 dhe 2020, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018,2019 dhe 2020 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të LMD-së, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore, nga data e ushtrimit të padisë e gjer në përmbushjen definitive të detyrimit.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën II të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, si dhe

Instituti “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7698/23, datë 13.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka